



05 /Nr. 4043 2022
Data: 06.06.2022

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 23.05.2022 në Sallën e Takimeve të Komunës së Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 15:00 prezent ishin 23 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Drejtori për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport z.Hisni Luri.

Rendi i Punës

1. Plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Hisni Luri është procedurë ligjore që të mbahet debati publikë për plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Rregullorja është shqyrtuar në komitet për politik e financa, në kuvendin e komunës dhe pas debatit publik do të përcillet për miratim në kuvendin e komunës. Para se me vazhduar me propozime për një fjalë përshëndetëse ftoj kryetarin e komunës.

Mehmet Ballazhi plotësim ndryshimi i kësaj rregullore është bërë që me ju mundësuar që të jenë pjesë e bursës edhe ata student të cilët nuk kanë mundur me u regjistruar në Universitetin e Prishtinës dhe të cilët janë regjistruar në Universitetin e Tetovës. Për vitin 2023 planifikojmë t'i ndajmë edhe dhjetë bursa më shumë. Në këtë vit janë ndarë 30 bursa prej komunës dhe 12 prej bizneseve private që do të thotë të gjithë ata student të cilët kanë aplikuar për bursë janë përfitues. Propozimet të cilat do të parashtroni në këtë debat do t'i përcjellim për shqyrtim në mbledhje të kuvendit.

Hisni Luri në këtë rregullore nuk ka ndryshime të tjera përveq se është shtuar edhe një pikë shtesë. Në faqen gjashtë neni 15.1.8 është shtuar edhe një pikë tjetër 15.1.8.1 të jetë studentë në universitetin publik të Maqedonisë Veriore pra janë të specifikuara fakultete. Arsyeja e plotësimit ndryshimit të kësaj rregullore është për shkak se studentët e komunës së Hanit të Elezit studimet i ndjekin në Universitet të Prishtinës dhe të Tetovës.

Faruk Berisha: propozoj që të përfshihen edhe studentët të cilët studiojnë në universitetin shtetëror të Shqipërisë.

Ahmet Krasniqi: propozoj që të përfshihen edhe studentët të cilët studiojnë në universitetin "Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Visar Hasallari: propozoj që studentët të cilët janë në OJQ-të e Hanit të Elezit dhe të cilët bëjnë punë vullnetare tu shtohen 3 pikë.

Hisni Luri a keni edhe ndonjë propozim për plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Nëse nuk keni propozimet e parashtruara do t'i përcjellim për në kuvend për shqyrtim dhe ata të cilët i vlerëson kuvendi që janë të arsyeshme besoj se do të miratohen.

Debati përfundoi në ora 16:04 .

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Drejtori për Arsimit Kulturë, Rini dhe Sport

Hisni Luri